

Prishtinë, 30 prill 2025

Bazuar në Rregulloren për Punën e Komisionit e Ankesave dhe të Arbitrazhit të Federatës së Basketbollit (FBK) të datës 30.08.2023, dhe Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore – Edicioni 2024/2025 (“PG”), si dhe në bazë të Ankesës së KB Bashkimi të datës 29.04.2025, Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit i FBK-së (“KAA”), me datë 30.04.2025 merr këtë:

V E N D I M

- I. Shpallet e PRANUESHME Ankesa e KB Bashkimi e datës 30.04.2025;
- II. APROVOHET pjesërisht Ankesa e KB Bashkimi e datës 30.04.2025 si e BAZUAR;
- III. NDRYSHOHET Informatori Play Off me Nr. 06/2024-25 i Komisionit të Garave të FBK-së me i datës 29.04.2025 përkitazi me ndëshkimin e shqiptuar ndaj KB Bashkimi.
- IV. Bazuar në Nenet 51.19 dhe 57.2 të PG, KB Bashkimi dënohet me:
 - €1,500.00 gjobë
 - 3 ndeshje pa shikues, nga të cilat:
 - o 1 ndeshje pa prezencë të shikuesëve fare; dhe
 - o 2 ndeshje pa prezencën e shikuesëve VIP (përfshijmë, lejohen nga 15 zyrtarë të klubeve dhe zyrtarët e lartë të FBK konform PG).
- V. MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Informatorit Play Off me Nr. 06/2024-25 të Komisionit të Garave të FBK-së me i datës 29.04.2025.

A R S Y E T I M

Më datë 29.04.2025, Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit i FBK-së, përmes postës elektronike, nga sekretarja e FBK, ka pranuar Ankesën e KB Bashkimi të datës 29.04.2025 (tash e tutje “Ankesa”), e cila ka të bëjë me Informatorin Play Off me Nr. 06/2024-25 të Komisionit të Garave të FBK-së me i datës 29.04.2025, (tash e tutje “Vendimi”), lidhur me incidentin e ndodhur gjatë lojës KB Bashkimi — KB Peja të zhvilluar më 27.04.2025.

Në këtë kuadër, KAA ka mbajtur takim më 30.04.2025 dhe ka shqyrtuar Ankesën e KB Bashkimi, si dhe provat e tjera që janë pjesë e dosjes së lëndës dhe të ofruara nga KB Bashkimi dhe nga FBK.



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Tel: +383 49 738-080, E-mail: federata@basketbolli.com, Lagjia “Arbëria”, Blloku C3, Nr: 83, Str: Radovan Zogovic, 10 000, Prishtina

Sipas kuptimit të KAA, KB Bashkimi sfidon Vendimin e Komisionit të Garave me të cilin KB Bashkimi dënohet me €2,000.00 dhe 3 ndeshje pa shikues.

Thelbi i Ankesës së KB Bashkimi është se dëshmitë, përkatësisht video inqizimi i incidentit në fjalë, tregojnë se ka pasur aplikim të gabuar të Nenit 52.16 të PG, dhe rrjedhimisht, dënimi i bazuar në atë dispozitë është jomeritor.

KAA gjatë trajtimit të lëndës ka shqyrtuar të gjitha dokumentet përkatëse dhe provat në dispozicion, përfshi këtu edhe video inqizimin e incidentit në fjalë, dhe ka konstatuar si në dispozitiv, për arsyet në vijim.

KAA vëren nga provat në shkresat e lëndës, dhe është e pakontestueshme, se KB Bashkimi ka dorëzuar brenda afatit ankesën e tyre ndaj Vendimit të Komisionit të Garave, dhe rrjedhimisht, konsiderohet si ankesë e pranueshme sepse janë përmbushur të gjitha kushtet, përfshirë edhe pagesën e taksës për ankesë.

Në vijim, KAA merr parasyshë bazën juridike të cituar nga Komisioni i Garave në këtë rast. Neni 52.16 i PG, mirëpo, me vrojtimin e videoinqizimit, shihet se sjellja e papërshtatshme ka rezultuar nga persona jozyrtar, përkatësisht, shikues VIP të lojës dhe shikues të rëndomtë të cilët kanë hudhë gjësende dhe mjete piroteknike në fushë. Si rezultat, KAA vlerëson se e drejta e aplikueshme për shqyrtimin e këtij rasti është Neni 51.19 i PG, i cili thotë si në vijim:

Realizimi i sulmit fizik me lëndim të lehtë të lojtarëve, zyrtarëve të klubeve, gjyqtarëve, vëzhguesit apo personave zyrtar nga persona jozyrtar.

Në këtë dispozitë parashihet shqiptimi i gjobës prej €1,500.00 dhe 3 ndeshje pa shikues.

Lidhur me ndëshkimin prej 3 ndeshje pa shikues, KAA ka marr parasyshë Nenin 57.2 të PG, i cili thotë:

Sipas vlerësimit të rrethanave, dënimi ndalesa e prezencës së shikuesëve mund të shqiptohet edhe si ndalesë e pjesëshme e prezencës së shikuesëve (ndalesë e përdorimit të tribunave/pjesëve të caktuara).

KAA e ka parasyshë dështimin e KB Bashkimi për të organizuar lojën në përputhje me standardet e nevojshme të sigurisë fizike. Mirëpo, në të njëjtën kohë, duke u thirrë në nenin e sipërcituar, KAA vlerëson se dënimi prej 3 lojëve duhet të kualifikohet në atë mënyrë, që 1 lojë të luhet nga KB Bashkimi pa shikues fare, ndërsa 2 lojë të tjera pa 3 ndeshje pa shikues, nga të cilat: 1 ndeshje pa prezencë të shikuesëve fare; dhe 2 ndeshje pa prezencën e shikuesëve VIP (përfshirë, lejohen nga 15 zyrtarë të klubeve dhe zyrtarët e lartë të FBK konform PG).



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Tel: +383 49 738-080, E-mail: federata@basketbolli.com, Lagjia "Arbëria", Blloku C3, Nr: 83, Str: Radovan Zogovic, 10 000, Prishtina

KAA vlerësoi që ky dënim i kualifikuar në këtë mënyrë është i përshtatshëm sepse në njërin anë nuk dëmton kualitetin e lojës të basketbollit në fazën e playoff, ndërsa në anën tjetër qon mesazhin e qartë tek KB Bashkimi, se organizimi i sigurtë i ndeshjeve është jetik për mbarëvajtjen e garave. Në këtë aspekt, mënyra e përcaktuar nga KAA, sipas diskrecionit nga Neni 57.2 të PG, i jep KB Bashkimi porosinë e duhur por edhe mundësinë e përmirësimit drejt organizimit të duhur të ndeshjes.

Rrjedhimisht, KAA duke u mbështetur në atë që u tha më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Partin Pruthi
Anëtar

Prishtinë, 30 prill 2025

Vendimi i dërgohet:

Komisioni i Arbitrazhit:



Korab R. Sejdiu
Kryetar



Lulzim Fushtica
Anëtar

- KB Bashkimi
- Komisionit të Garave të FBK-së
- Anëtarëve të Komisionit të Arbitrazhit
- Arkivit të FBK-së

Këshilla Juridike:

Vendimet e Arbitrazhit janë definitive, dhe kundër tyre nuk është e lejuar ankesa brenda FBK-së. Palët e pakënaqura me vendimin e Komisionit të Arbitrazhit kanë të drejtë të ankesës të Këshilli i Arbitrazhit Sportiv (KAS) dhe në Gjykatën kompetente përkatëse.



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Tel: +383 49 738-080, E-mail: federata@basketbolli.com, Lagjia "Arbëria", Blloku C3, Nr: 83, Str: Radovan Zogovic, 10 000, Prishtina